



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo  
Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

**Akademia e Kosovës për Siguri Publike**

Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

**Fakulteti i Sigurisë Publike**

Fakultet Javne Bezbednosti / Faculty of Public Safety



---

**FTESË PËR PJESËMARRJE**  
**NË KONFERENCËN SHKENCORE**

**“SFIDAT E SIGURISË NË KOSOVË”**

**AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**  
**29 Maj 2017, VUSHTRRI**

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është e nderuar të njoftojë organizimin e konferencës së parë shkencore “Sfidat e Sigurisë në Kosovë”.

Në vizionin dhe misionin e këtij aktiviteti periodik është të nxisë hulumtimet, kërkimin, diskutimin dhe të menduarit kritik rreth çështjeve të lidhura me sigurinë publike në Kosovë si dhe sfidat dhe rreziqet si parakusht për shtetin ligjor.

Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është të stimulojë debatin ndërmjet nivelit akademik, ekspertëve, përfaqësuesve të organizatave të zbatimit të ligjit në Kosovë, si dhe grupeve të interesit etj. në mënyrë që të prezantojnë gjetjet e tyre më të rëndësishme për çështjet, problemet dhe proceset e një interesi më të madh, të cilat janë prezentë në Kosovë, në rajon e më gjerë në Evropën Juglindore.

Një prej objektivave kryesorë të këtij aktiviteti shkencor është të identifikojë dhe të ndajë ide e zgjidhje praktike të bazuara me argumente shkencore që mbështesin objektivat e mirëqeverisjes dhe demokracisë, duke e orientuar këtë proces në harmonizimin e tre aspekteve kryesor që janë shteti, shoqëria dhe siguria. Ky aktivitet ofron një mundësi për të sjellë bashkë palët e interesuara nga qeveria, komuniteti akademik, përfaqësues nga agjencionet e zbatimit të ligjit në mënyrë që të ndajnë zgjidhje praktike drejt arritjes së një shoqërie të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Për të kontribuar në këtë drejtim Akademia e Kosovës për Siguri Publike dhe do të organizojë konferencë, punimet e së cilës do jenë objekt i debatit publik, i medias dhe më tej i botimit profesional në një përmbledhje të referimeve.

Të gjithë pjesëmarrësit e interesuar mund të paraqesin një abstrakt me 200-300 fjalë. Abstraktet do të shqyrtohen dhe pranohen mbi bazën e cilësisë së tyre dhe lidhjes me fushën e studimit të Konferencës. Të gjithë autorët e përzgjedhur për të marrë pjesë, do të njoftohen nëpërmjet një e-maili, në mënyrë që të dërgojnë punimin e tyre të plotë. Punimi i paraqitur duhet të jetë në

përputhje me linjat e propozuara në abstrakt. Të gjitha punimet e përzgjedhura për pjesëmarrje duhet të jenë origjinale dhe të mos jenë publikuar tjetërkund.

### **Konferenca do të jetë e përqendruar, por jo e kufizuar në tematikat e mëposhtme:**

1. Sfidat e globalizmit (terrorizmi, krimi i organizuar, korrupsioni, trafikimi me qenie njerëzore, kriminaliteti kibernetikë, kontrabandimi me narkotikë, kontrabandimi me armë, kontrabandimi me mallra)
2. Sfidat e integritetit të Ballkanit Perëndimor Institucionet dhe e drejta
3. Ndikimi i krimit të organizuar në demokraci
4. Roli dhe funksioni i institucioneve të sigurisë në qeverisjen demokratike

### **DATA TË RËNDËSISHME**

Dorëzimi i Abstrakteve	8 maj 2017
Njoftimi i Pranimit	15 maj 2017
Dorëzimi i Punimeve	22 maj 2017
Data e Konferencës	29 maj 2017

Propozimi me 200-300 fjalë duhet të dërgohet në e-mail ose CD në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike:

### **Udhëzime për Abstraktin:**

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

- Gjuhët zyrtare të Konferencës janë shqip, serbisht dhe anglisht. Abstrakti i punimeve të paraqitura në gjuhën shqipe duhet të dërgohet në shqip dhe anglisht.
- Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre, si dhe 4-5 fjalë kyçe.
- Emrin e plotë të autorit/autorëve, përkatësinë institucionale, panelin përkatës, dhe adresën e e-mail-it.
- Formati: Abstraktet duhet të paraqiten në formatin Microsoft Word.

### **Udhëzimet për shkrimin e Punimit:**

- Punimi duhet të shkruhet në një dokument Word dhe nuk duhet të jetë më i gjatë se 10 faqe.
- Punimet mund të shkruhen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- Formati i shkrimit: 12-pt. Font Times New Roman dhe 10-pt. për referencat, shtojcat, shënimet në fund të faqes, tabelat dhe figurat.

**Përparësitë e pjesëmarrësve:**

- Një kopje të përmbledhjes së punimeve;
- Certifikatën e Pjesëmarrjes;

**Format e prezantimit të punimeve:**

- Prezantim Verbal
- Prezantim me Power point

Lutemi që pjesëmarrësit të përcaktojnë formën e prezantimit të dëshiruar në propozimin e tyre të punimit.

Një autor nuk mund të marrë pjesë në më tepër se në dy punime.

Bordi shkencor do të përzgjedhë 20 punimet më të mira të cilat në përfundim të Konferencës do të botohen në formë përmbledhjeje të punimeve të konferencës.

**Do t'iu ish mirënjohës nëse ju e ndani këtë Thirrje për Pjesëmarrje të Konferencës edhe me kolegët dhe bashkëpunëtorët tuaj.**

**Ju falënderojmë për interesimin tuaj,**

**Për çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni:**

Komisionin për organizimin e Konferencës

1. Dr.Sc.Besnik Fetahu

Email:besnik.fetahu@rks-gov.net

2. Dr.Sc.Nexhat Jashari

Email:nexhat.jashari@rks-gov.net

3. Mr.Sc.Florentina Braha

Email: florentina Sh.braha@rks-gov.net

4. Avni Istrafi

Email:avni.istrefi@rks-gov.net